

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË



Ekspoze e temës së masterit:

POLITIKA E JASHTME E SHETIT SHQIPTAR 1920-1939

Mentori:

Prof. Asoc. Dr.Nuri Bexheti

Kandidati:

Berat Bajraktari

Prishtinë: Korrik 2021

EKSPOZE E TEMËS

POLITIKA E JASHTME E SHTETIT SHQIPTAR 1920-1939

Mentor:

Prof. Asoc. Dr. Nuri Bexheti

Kandidati:

Berat Bajraktari

Në temën e masterit “Politika e jashtme e shtetit shqiptar 1920-1939” janë trajtuar çështje të ndryshme nga politika e jashtme e Shqipërisë, duke filluar me përpjekjet latente të aktereve politikë shqiptarë të kohës për të siguruar rinjohjen e pavarësisë së Shqipërisë, në kohën kur po krijoheshin rendi i ri pas Luftës së Parë Botërore. Vend të rëndësishëm gjatë kësaj periudhe zënë poashtu edhe raportet shqiptaro-jugosllave, me fokus të veçantë në raportet shqiptaro-italiane të cilat zënë një vend bosht në këtë punim.

Temën të cilën e kemi për objekt studimi, shpërfaqë në radhë të parë evoluimin e brendshëm institucional të shtetit shqiptar gjatë periudhës 1920-1939, periudhë e cila reflektonte vazhdimisht edhe pozicionin e tij diplomatik në konjunkturën politike të kohës. Pozita gjeostrategjike dhe resurset natyrore të Shqipërisë ishin ndër elementet që e faktorizonin atë në gjeopolitikën e arealit ballkanik, elemente këto që nxisnin edhe rivalitetin e shteteve fqinje për ndikim në Shqipëri. Figurë qendrore e politikës së jashtme të shtetit shqiptar në periudhën e lartëcekur ishte Ahmet Zogu, fillimisht si kryeministër pastaj si president i republikës dhe në fund si Mbret i Shqiptarëve. Mund të themi se shteti shqiptar gjatë kësaj periudhe kohore tentonte vazhdimisht që nëpërmjet një politike të jashtme aktive, të krijonte aleatë potencial, përkrahja e të cilëve ishte *conditio sine qua non* për konsolidimin e mëtutjeshëm shtetëror.

Gjatë punës studimore për të finalizuar këtë tezë masteri, asesi nuk është anashkaluar metodologjia e saktë shkencore. Disa nga metodat e përdorura në këtë punim janë: metoda e

analizes, sintezes, krahasimit, metoda statistikore, përshkruese etj; përdorimi i të cilave ishte më se i domosdoshëm për të hedhur dritë mbi çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me tematikën e studiuar. Komploti ndërkombëtar ndaj qeverisë së Nolit, “dhurimi” i Shën Naumit dhe Vermoshit, politika filo-italiane e Ahmet Zogut, e qëndrimi i shtetit shqiptar ndaj cënimit të drejtave të shqiptareve jashtë Shqipërisë janë disa nga çështjet të cilat do të përpiqemi t’u japim përgjigje në kapitujt vijues.

Punimi perbehet gjithesejt nga 5 kapituj ne te cilet trajtohen qeshtje te ndryshme politike e diplomatike ne shtetin shqiptar pergjate periudhes 1920-1939.

Pas mbarimit të luftës, filluan përpjekjet diplomatike nga shtetet triumfuese për krijimin e rendit të ri botëror në atë që njihet si Traktati i Versajës, dhe kapitulli i parë fillon me përshkrimin e tentativave sistematike të delegacioneve shqiptare që morën pjesë në këtë Konferencë, për të siguruar rinjohjen e pavarësisë së Shqipërisë, pasi që me rrethanat e reja gjeopolitike vihej në diskutim edhe ekzistimi i një shteti të pavarur shqiptar në kufinj të para luftës. Pastaj kapitulli vazhdon me trajtimin e problemit shqiptar në bisedimet e paqes në kuadër të “Çështjes së Adriatikut”, ndërhyrjen decisive të presidentit W.Wilson - ndërhyrje e cila ndaloi copëtimin e shtetit shqiptar, aspektin diplomatik të luftës së Vlorës, dhe marrëveshjen e gushtit të vitit 1920 me Italinë, në të cilën parashihej dislokimi i trupave italiane nga Shqipëria, me përjashtim të ishullit të Sazanit. Kapitulli mbyllet me pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, e cila përbënë një etapë më se të rëndësishme në forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të shtetit shqiptar.

Kapitulli vijues vazhdon me trajtimin e çështjeve me rëndësi të veçantë, nga zhvillimet politike e diplomatike gjatë harkut kohor mes viteve 1921-1925 si: ndërhyrja jugosllave në Shqipëri nëpërmjet prijësit me prirje separatiste të Mirditës, Gjon Marka Gjonit, vendimet finale të Konferencës së Ambasadorëve, grusht shtetin e Nolit dhe refuzimin ndërkombëtar për njohjen e qeverisë së tij, si dhe caktimin përfundimtar të kufirit të Shqipërisë me Mbretërinë SKS.

Në kapitullin e tretë fokusi ynë zhvendoset në vrojtimin e politikës së jashtme të shtetit shqiptar gjatë viteve 1925-1928, periudhë kjo e cila ishte vendimtare dhe përcaktuese për orientimin politik e diplomatik që do merrte shteti shqiptar më vonë. Kapitulli hapet me kthimin e Ahmet Zogut në pushtet pas përmbysjes së qeverisë demokratike të Nolit, në të cilën impakt të madh përveç

shteteve fqinje kishin edhe fuqitë evropiane. Duke ndjekur rrjedhën kronologjike të ngjarjeve, vazhdohet me trajtimin e marrëveshjeve ekonomiko-politike të arritura me Italinë siç ishin: marrëveshja për themelimin e Bankës Shqiptare, të SVEA-s, nënshkrimi i Paktit të Parë dhe të Dytë të Tiranës, të cilat shënojnë rritjen drastike të ndikimit të politikës italiane në Shqipëri.

Në pjesën e dytë trajtohen edhe përpjekjet për arritjen e marrëveshjeve me karakter ekonomik edhe me Mbretërinë e SKS-së, marrëveshje këto fatkeqësisht të mbetura në tentativë për shkak të acarimit të raporteve ndërmjet dy shteteve pas nënshkrimit të Paktit të Dytë të Tiranës, edhe pse me finalizimin e tyre përfitimi do ishte reciprok. Ndërsa në fund të këtij kapitulli, është paraqitur qëndrimi i shtetit shqiptar ndaj reformës agrare dhe kolonizuese në Kosovë, e cila pati si konsekuencë shpërnguljen në masë të shqiptarëve nga Kosova.

Në kapitullin përmbyllës kemi trajtuar aspekte të ndryshme nga politika e jashtme gjatë periudhës 1928-1939. Njëra ndër ngjarjet e rëndësishme që përkon me këtë periudhë ishte ndryshimi i sistemit të qeverisjes më 1 shtator 1928, që mundësoj kalimin e qeverisjes nga presidenca në monarki. Edhe pse ky ndryshim lidhej më shumë me politikën e brendshme, ai u prit me jehonë dhe nxiti reagim edhe në politikën e jashtme, sidomos atë ballkanike. Në nëntitullin qendror kemi paraqitur përpjekjet e mbretit shqiptar që të shkëputej nga varësia italiane, me përpjekjet e tij të vazhdueshme për pjesëmarrje në organizimet politike rajonale si Pakti Ballkanik, që në fund rezultuan të pafrytshme si pasojë e presionit italian mbi shtetet ballkanike dhe mungesës së vullnetit të tyre për anëtarësim të Shqipërisë Italia kaloi nga plani i depërtimit ekonomik në atë të pushtimit ushtarak, e shtyrë edhe nga politika pasive e fuqive evropiane dhe nga marrja e dritës së gjelbërt nga Hitleri. Këto zhvillime do të trajtohen në këtë aleancë. Në anën tjetër, nëntitulli përmbyllës shpërfaqë veprimet e intensifikuara të Ahmet Zogut për zëvendësimin e pranisë italiane në Shqipëri dhe angazhimin e kapitalit asnjëses. Ndër veprimet e ndërrmarra në këtë drejtim ishin: mos vazhdimi i Paktit të Parë të Tiranës, shtetëzimi dhe mbyllja e shkollave të huaja, gatishmëria për t'u bërë pjesë e Paktit Ballkanik dhe Antantës së Vogël, largimi i instruktorëve ushtarak italianë, nënshkrimi i marrëveshjes tregtare me Jugosllavinë, etj. Me rrethanat e ndryshuara në gjeopolitikën e kohës, gjerësisht në këtë nënkapitull.